



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1055_09_13**;
- Ankesa e KEDS-it e datës 16.12.2013.

në seancën e mbajtur më datë 27 dhjetor 2013, nxorri këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e KEDS-it ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin A. D. (shifra e konsumatorit DPR - 92750) nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1055_11_13 i datës 07.11.2013.

Arsyetim

Departamenti i faturimit në KEK me datë 04.04.2013 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike në vlerë financiare 141.46€.

Pas arritjes së kësaj fature të energjisë elektrike, konsumatori me datë 08.04.2013 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK, duke kundërshtuar faturën e energjisë elektrike të muajit mars 2013, si dhe faturimin për periudhën 2012 deri në mars 2013.

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse me datë 12.04.2013 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 6003428: TL=84405 kW dhe TU= 53573 kW, si dhe kanë evidentuar që njehsori elektrik bënë matjen vetëm në tarifën e ulët. Pas kësaj punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse prapë me datë 16.04.2013 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 6003428: TL=84423 kW dhe TU= 53653 kW.

Departamenti për Konsumator në KEK me datë 24.04.2013 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në procesverbalin e inspektimit nr. 2412875 e datës 16.04.2013 si dhe listave të leximit për periudhën shkurt dhe mars 2013.

Konsumatori pas përgjigjes së KEK-ut ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. DMK pas ankesës së konsumatorit ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe me datë 07.11.2013 ka nxjerr vendim duke e aprovuar ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KKDFE që të korrigoj faturat e energjisë elektrike nr. 12120DPR-92750, 01130DPR-92750, 02130DPR-



92750 dhe 03130DPR- 92750, respektivisht faturat e muajve 12/2012, 01/2013, 02/2013 dhe 03/2013, duke bërë shpërndarjen e kilovatëve të regjistruar në tarifën e ulët për periudhat janar, shkurt dhe mars 2013, si në vijim: periudha dhjetor 2012 me relacion TL=34% dhe TU= 66%, periudha janar 2013 me relacion TL=40% dhe TU=60%, periudha shkurt 2013 me relacion TL=41% dhe TL=59%, dhe periudha mars 2013 me relacion TL=37% dhe TU=63%.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 27.09.2013 KEDS-i ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Baza e kundërshtimeve të KEDS-it të theksuara në ankesë është se sipas listave të leximit për periudhat 12/2012 e deri më 03/2013 lexuesi ka bërë leximin e drejtë të gjendjes së tarifave të njehsorit dhe në bazë të kësaj tarifori ka mbetur në gjendjen e dytë, pra njehsori ka regjistruar vetëm me një të njëritë.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 27 dhjetor 2013 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit, me të cilën pretendohet se DMK, gjatë vendosjes së kësaj çështje nuk ka vlerësuar mirë provat dhe faktet e prezantuara. Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se sipas procesverbalit të kontrollës nr. 2412720 të datës 12.04.2013 kanë evidentuar që njehsori elektrik bënë matjen vetëm në tarifën e ulët, si dhe të njëjtën konstatim e kanë bërë edhe në procesverbalin nr. 2412875 të datës 16.04.2013, dhe se sipas kësaj vërehet se punëtorët e autorizuar të kontrollës në asnjërin prej procesverbaleve nuk kanë evidentuar se duhet të rregullohet njehsori ashtu që të regjistrojë energji elektrike në të dy tarifën, apo të udhëzojnë konsumatorin se njehsori elektrik duhet t'i rregullohet ndërruesi tarifor, duke pasur parasysh se mos funksionimi i ndërruesit tarifor ka ndodhur që nga periudha e muajit janar 2013.

Sa i përket pretendimit të KEDS-it se sipas listave të leximit prej periudhës 12/2012 e deri më 03/2013 lexuesi ka evidentuar se ke lexim të rregullt dhe se njehsori elektrik për katër muaj ka regjistruar vetëm në një të njëritë, duhet theksuar se sipas analizës së listave të leximit konstatohet se shpenzimi i energjisë elektrike i konsumatorit në tarifën e lartë për periudhat janar, shkurt dhe mars 2013 mbetet i pa ndryshueshëm nga gjendja e regjistruar në periudhën nëntor të vitit 2012, e që vërteton që njehsori elektrik i konsumatorit apo ndërruesi tarifor nuk ka bërë matjen e energjisë elektrike të shpenzuar në tarifën e lartë.

Bordi i ZRRE-së gjatë analizës së dokumenteve të paraqitura ka vërejtur se sipas listave të leximit për periudhën e muajit janar, shkurt dhe mars 2013 dhe procesverbalit të kontrollës gjendja e shpenzimeve të evidentuara për periudhat e lartë përmendura nuk përputhen plotësisht me gjendjen e evidentuar në procesverbalin e inspektimit nr. 2412720 të datës 12.04.2013 në tarifën e lartë.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KKDFE në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 27.12.2013 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1055_09_13, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar